



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"

# TREGJET DHE INSTITUCIONET FINANCIARE

## HYRJE NË TREGJET DHE INSTITUCIONET FINANCIARE

*Ph.D. Fisnik Morina*



SHKURT , 2018



© Can Stock Photo - csp18145180

# TREGJET DHE INSTITUCIONET FINANCIARE

- Lënda: Tregjet dhe Institucionet Financiare
- Viti II-të, Semestri IV, Departamenti: Administrim Biznesi
- Statusi i lëndes: Obligative
- Javët mësimore: 15 (2 orë ligjerata, 2 orë ushtrime)
- Mësimdhënesit: Prof. Asoc. Dr. Halil Kukaj  
Ph.D. Fisnik Morina
- Emaili: [halilkukaj@yahoo.com](mailto:halilkukaj@yahoo.com)  
[fisnik.morina@unhz.eu](mailto:fisnik.morina@unhz.eu)

# Qëllimet e lëndës:

- Qëllimi i lëndës është që të elaborojë kuptimin e sistemit financiar, dhe që të ofrojë njohuri për studentët në lidhje me mekanizmat, strukturën dhe praktikën e aktiviteteve të sistemit financiar modern, tregjet financiare dhe institucionet financiare.
- Studentët do të jenë në gjendje për të kuptuar teorinë, njohuritë themelore dhe teknikat e përdorura në sektorin financiar, për të kuptuar ngjarjet e rëndësishme financiare dhe marrjen e vendimeve financiare.

# Përshkrimi i lëndës

- Lënda ofron njohuri bazë për tregjet financiare, segmentet e sistemit financiar, letrat me vlerë, bursat dhe sistemin European financiar.
- Lënda fokusohet kryesisht në rolin e tregjeve financiare dhe institucioneve financiare në ekonomi.
- Ai synon t'u japë studentëve të kuptuarit për llojet e ndryshme të tregjeve dhe institucioneve financiare, instrumentet financiare, funksionimin e tregjeve dhe institucioneve financiare ndërkombëtare, bashkëveprimet ndërmjet pjesëmarrësve kryesor të tregut, mjedisin rregullativ dhe institucional në të cilin ata veprojnë.
- Kjo lëndë studion lloje të shumta të instrumenteve financiare, të tilla si aksione dhe obligacione, dhe instrumente moderne financiare të tilla si instrumentet derivative (opcionet, kontratat fjuçers, swaps kontratat etj).

# Rezultatet e pritura të nxënies:

- Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:
  - Të dijë se si duhet të organizohen tregjet financiare; në veçanti tregjet e parasë dhe të kapitalit.
  - Mund ta krahasojë zhvillimin e tregjeve dhe të instrumenteve financiare me vendet e tjera të zhvilluara dhe me ato që janë në tranzicion (vendet në regjion).
  - Zhvillon koncept të qartë se si duhet të jetë një sistem ekonomik dhe financiar.
  - Definitivisht, pas leksioneve të kursit, studenti që me sukses e përfundon këtë cikël të ligjëratave, më lehtë e kupton dhe shumë më lehtë inkorporohet në jetën ekonomike që ndërtohet në ekonominë e tregut.

# Metodologjia e mësimëdhënies:

- Prezantimi i temës mësimore në Power Point
- Përsëritja e temës paraprake nga grupi i caktuar i studentëve, analiza dhe diskutime
- Rast studimi apo detyrë (për orën e ushtrimeve) lidhur me temën e ligjëruar

# Metodat e vlerësimit:

- Prezantimi dhe puna grupore: 0 - 10%
- Punimi seminarik: 0-10%
- Testi I 0-45%
- Testi II 0-45%
- Provimi përfundimtar 0- 90%

# Literatura bazë:

- Aristotel Pano, Elisabeta Gjoni - TREGJET FINANCIARE  
Instrumentet dhe veprimet e tyre
- Lavdosh Zaho - TREGJET DHE INSTITUCIONET FINANCIARE
- Frederic Mishkin & Stenly G. Eakins - Tregjet dhe institucionet  
financiare Pjesa e I



# Hyrje

9

## Financa si shkencë dhe sistemi financiar :

- Financa -> arti dhe shkenca e administrimit të parasë.
- Funksioni i financës -> shpërndarja e burimeve, përfshirë edhe sigurimin e burimeve, investimin dhe menaxhimin e tyre.
- Sistemi financiar -> vend qe historikisht funksionon në shërbim të grumbullimit të fondeve dhe shpërndarjes së tyre në ekonomi.

► *Efiçenca e sistemit financiar rritet ngjashmërisht me rritjen e përdorimit të kursimeve të individëve nga ana e investitorëve.*

### **Komponentët e një sistemi financiar:**

- **Instrumentat financiare**, dëshmi dokumentare të detyrimeve lidhur me këmbimin e burimeve ndërmjet palëve kontraktuese;
- **Tregjet financiare**, vendet ku tregtohen instrumentat financiare;
- **Institucionet financiare**, organizma financiare, që krijojnë dhe tregtojnë instrumentat financiare dhe lehtësojnë rrjedhjen e fondeve;
- **Normat**, tërësia e rregullave që disiplinojnë sjelljen e çdo pjesëmarrësi.

# Rëndësia e lëndës “Tregje dhe Institucione Financiare”

11

- Thellimi ne studim te specializuar te: **finances, ekonomiksit** etj. dhe nderlidhja qe ka me njohurite e marra nga: **makroekonomia, financat në përgjithësi dhe personale, investimet.**
- Sistemi financiar në çdo vend është në **evoluim** të përhershëm.
- Në kohën e sotme **ekonomia**, ecurinë e saj e mbështet në mbarëvajtjen tregjeve financiare. Popullarizimi i idesë së investimeve në bursa.
- Për një mënyrë sa më efikase të përdorimit të **mjeteve monetare** në dispozicion.
- Shumat e medha të mjeteve monetare dhe numri i madh i kompanive ne **bursa.**
- **Globalizimi** i ekonomisë dhe **tregtimi on-line** i titujve financiarë ka hequr barrierat mes vendeve dhe popujve.
- Luhatjet e indekseve të bursës si **indikatorë të ekonomisë** së një vendi dhe të ndryshimeve qeveritare apo krizave të mundshme.


- Cili është kuptimi dhe esenca e letrave me vlerë?
  - *Dokumente me shkrim, më të cilat emetuesi i tyre obligohet të përmbushë detyrimet (e shënuara në keto letra) ndaj poseduesve të tyre.*
  - *Juridikisht merr vlerë nga e drejta që i inkorporohet kesaj letre.*
  - *Funksioni themelor ekonomik -> zëvendësimi i mënyrës së pagesave me para të gatshme.*

Ne lidhje me këtë nënçështje le të shohim:

- a. Karakteristikat e përbashkëta të letrave me vlerë**
- b. Llojet e letrave me vlerë**
- c. Instrumentët financiarë dhe klasifikimi i tyre**

# Institucionet financiare dhe klasifikimi i tyre

13



## Institucionet financiare - Ndërmjetës të specializuar financiarë

- ❑ Kryejne nje sere sherbimesh dhe me veprimtari te automatizuara
- ❑ Sigurojne informacion te plote dhe jo shume te kushtueshem

# Klasifikimi i institucioneve financiare

14

## □ *Institucionet financiare depozituese*

- Ofrojnë shumëllojshmëri llogarish të çekueshme dhe kursimi (me afat, pa afat).
- Paratë i përdorin për kreditim biznesesh dhe individësh, për dhënie huash etj.
- Përfshin: bankat tregtare, shoqëritë e kursim- kreditit, bankat e kursimeve etj.

## □ *Institucionet financiare kontraktuale*

- Hartojnë kontrata me klientët e tyre, ku u sigurojnë mbrojtje financiare nga humbja e jetës apo pasurisë.
- Paratë e grumbulluara i investojnë në instrumenta financiare të tregut të kapitaleve.
- Burimi i fondeve të tyre: pagesa e kuotave të përcaktuara në kontratë.
- Përfshin: kompanitë e sigurimit, të jetës dhe pasurisë, si dhe fondet e pensioneve.

## □ *Institucionet financiare të tjera*


- Blejnë letra me vlerë nga njësitë deficiçtare dhe ia shesin ato njësisive sufiçitare.
- Burimi i fondeve të tyre: duke ofruar publikut L.V. të borxhit me një normë kthimi.
- Përfshin: kompanitë financiare, fondet reciproke, agjensitë qeveritare, etj.

## □ *Kompanitë financiare*

- Ofrojnë kredi konsumatore dhe kredi për bizneset.
- Grumbullojnë paratë nga shitja e letrave me vlerë që i emetojnë vetë.

# Tregjet financiare dhe klasifikimi i tyre

15



- *Tregjet Financiare* – vende te specializuara, ku transferohen fondet monetare nga njesite suficitare tek ato defiçitare npj. Instrumenteve Financiare dhe ku përcaktohen çmimet (kuotimet) e ketyre instrumentave.

# Klasifikimi i tregjeve financiare

16

- a) *Sipas maturimit te instrumenteve financiare që tregtohen në këto tregje.*
- **tregje te parasë**
  - **tregje të kapitalit**
- b) *Sipas kohës së emetimit të instrumenteve financiare që tregtohen në tregjet financiare*
- **tregje parësore (primar)**
  - **tregje dytësore** (Bursat si ato të New York, Tokio, Londër, Paris, Hong Kong, etj.)
- c) *Sipas shkallës së organizimit*
- **tregjet e organizuara** (bursa e letrave me vlerë)
  - **tregjet mbi banak, OTC (Over the Counter)** - realizimi i biznesit me anë te mjeteve moderne të telekomunikacionit dhe mungesa e tregtimit të centralizua
- d) *Sipas shkallës së efektivitetit*
- **tregje efektive** - kur çmimet e letrave me vlerë reflektojnë tërësisht të gjithë informacionin në zotërim
  - **tregje jo efektive** - kur çmimet e letrave me vlerë nuk shprehin gjendjen dhe perspektivën e kompanisë
- e) *Sipas kohës së kryerjes së transaksioneve*
- **tregje spot** (tregje cash) - transaksionet shoqërohen me derdhjen e parave (1 ditë, 1 javë)
  - **tregje të së ardhmes** - njerëzit kontraktajn për transaksione në të ardhmen.



# Ju Faleminderit për vëmendje !

□ SUKSESE !

